



Prishtinë, 13.05.2024  
Kodi i ZRRE-së: V\_2017\_2024

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji;
- Metodologjinë e Taksave të Kycjes të Rrjetit të Shpërndarjes;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_R\_2518\_03\_24** i dt.28.03.2024;

në seancën e mbajtur më datë 13.05.2024 nxori këtë:

### V E N D I M

- I. REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e aplikuesit **B.P, "TREGTIA" SHPK** nga Komuna e Prishtinës si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II. MBETET** në fuqi Vendimi i KEDS-it me nr. 278, i datës 10.01.2024
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

### A r s y e t i m

Aplikuesi B.P "TREGTIA" SHPK me datë 04.01.2024 dhe me datë 19.01.2024, përmes përfaqësuesit të autorizuar, Zyra e Avokatisë "Pallaska & Associates", ka paraqitur ankesë pranë DMK-së në ZRRE duke kontestuar Përgjigjen të Departamentit për Shërbime me Konsumatorë në KEDS të datës 10.01.2024 me nr.278, dhe Pëlqimin Elektroenergjetik (PEE) të KEDS nr.7696 të datës 28.07.2023, me propozimin që ankesa të aprovohet si e bazuar në tërësi, dhe me kërkesën që t'i lejohet kyçja e përkohshme e objekteve.

Aplikuesi B.P "TREGTIA" SHPK me datë 26.06.2023 ka aplikuar në KEDS për Pëlqim Elektroenergjetik për kyçjen e objekteve banesore të reja R9 dhe R7 me total 1,142 njësi, e me fuqi Pm<sub>nj</sub>=3,997 kW.

**Provë:** Kërkesa për Pëlqim Elektroenergjetik nr.1116110 të datës 26.06.2023

Me datë 28.07.2023 KEDS ka lëshuar Pëlqimin Elektroenergjetik dhe Zgjidhjen Teknike nr.7696, ku ka theksuar se: Aplikuesi është pajisur fillimisht me PEE nr.3901 të datës 18.06.2019 me furnizim nga Trafostacioni (TS) ekzistues për energjizim të punishtes (fuqi Pm<sub>nj</sub>=150 kW) për ndërtimin e kompleksit të ri afaristo banesor "Kodrina". Pastaj në PEE është potencuar se aplikuesi është pajisur edhe me PEE nr.5082 të datës 08.06.2021, ku përmes këtij PEE, i është lejuar kyçje e përkohshme si dhe ndërtimi i dy trafo stacioneve të reja me fuqi S<sub>n</sub>=2x1600 kVA, dhe është cekur që në PEE të ardhshme aplikuesi duhet të implementoj linjën e re 10(20) kV nga Nënstacioni (NS) i KOSTT-it (Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut) deri në kompleksin "Kodrina", ku duhet të kyçen të gjitha objektet tjera duke përfshirë edhe blloqet R9 dhe R10. Investitorit i është përgatitur PEE nr. 6579 dt. 01.07.2022 për kyçjen



e përkohshme të punishtes në trafo stacionin me kod: 19000078223, të cilin PEE nuk e ka realizuar. Pastaj aplikuesi është pajisur me PEE nr. 12677 të datës 05.12.2022 për realizimin e linjës nga NS 110/10(20)kV Prishtina 7, të cilën PEE nuk e ka realizuar. Në vijim është potencuar që aplikuesi tani ka bërë kërkesë që lënda të procedohet përmes Metodologjisë së taksave për kyçje. Pas shqyrtimit të kërkesës së investitorit, KEDS lëshon këtë PEE të ri me kushte të specifikuara si në dokumentin në shkresa të lëndës.

**Provë:** PEE dhe ZT nr. 7696 datë 28.07.2023

Me datë 21.08.2023 aplikuesi bazuar në Pëlqimin Elektroenergjetik dhe Zgjidhjen Teknike nr. 7696 të datës 28.07.2023 ka aplikuar Departamentin e Investimeve në KEDS për aprovim projekti.

**Provë:** Kërkesa për aprovim Projekti nr.1173894 e datës 21.08.2023

Me datë 28.08.2023 Departamenti i Investimeve i ka kthyer përgjigje aplikuesit me vërejtjet si me poshtë: i) Linja e re nga NS Prishtina7 deri te "Stabilimenti 1" duhet të shtrihet në kanal të ri me gypa dhe puseta. Kanali të hapet përgjatë vijës së njëjtë me kanal in ekzistues në anën tjetër të rrugës; ii) Në situacionin të specifikohet lloji i kanalit të ri që do të hapet brenda kampusit të objekteve. Kanali duhet të ketë gypa të mjaftueshëm në mënyrë që kabllo e Tensionit të Ulët (TU) të vendosen në gypa të veçantë; iii) Në skemën njëpolare të Tensionit të Mesëm (TM) të vendoset edhe kthina dalëse në NS Prishtina 7.

**Provë:** Përgjigja nga Departamenti i investimeve date 28.08.2023

Pas takimit të mbajtur me zyrtaret e KEDS dhe Tregtisë të datës 13.10.2023 mbi mundësinë e përdorimit të kanalit ekzistues te KEDS-it Departamenti i investimeve ka lëshuar/ka kthyer përgjigje kompanisë për projektin e dorëzuar me vërejtjet si me poshtë: i) Linja e re nga NS Prishtina 7 deri te "Stabilimenti 1" duhet të shtrihet përgjatë trasesë së kanalit ekzistues ashtu që pas implementimit të linjës së re në kanal duhet të mbeten dy gypa lire; ii) Në situacionin me ortofoto të specifikohet lloji i kanalit të ri që do të hapet brenda kampusit të objekteve. Kanali duhet të ketë gypa të mjaftueshëm në mënyrë që kabllo e TU të vendosen në gypa të veçantë ose duhet të rritet seksioni i daljeve të TU; iii) dhe Dokumentacioni i nënshkruar dhe i vulosur në dy kopje mund të sillen në KEDS.

**Provë:** Përgjigja nga Departamenti i investimeve i datës 06.11.2023

Me datë 22.11.2023 aplikuesi i është drejtuar përmes shkrese zyrtare KEDS-it ku ka theksuar se përmes kësaj shkrese kërkojmë mirëkuptimin tuaj për sa i përket kërkesës tonë për kyçje të përkohshme të tri trafove te reja nëpërmjet trafove aktuale ekzistuese ne linjën 10 kV. Në kërkesë po ashtu është specifikuar se: *“Ne pa humbur kohë e kemi realizuar projektin sipas udhëzimeve të dhëna nga ana juaj dhe të njëjtin e kemi dorëzuar menjëherë tek ju për aprovim. Pas pak kohe na është thënë që të njëjtin projekt nuk e ka pranuar komisioni, ndërkaq kanë kërkuar që të një trase e re prej 3.5 km, për të cilën realisht konsiderojmë se ka qenë një investim i porealizueshëm në praktikë. Pas kësaj me datë 05.10.2023 ne kemi bërë kërkesë për takim me drejtorin ekzekutiv Alpin Dogan në mënyrë që të kishim mundësinë të diskutonim dhe po ashtu të gjenim zgjidhje për problemet eventuale në lidhje me kushtet për te cilat kishim aplikuar. Pas takimit, menjëherë pas kësaj ne kemi bërë projektin por një ekzekutim te tillë, lidhur me këtë kemi vërtetuar gjendjen e pusetave (shaktave) dhe trasesë, dhe kemi parë se është vështirë e realizueshme ne terren, për arsye se rrëmihja (gërmimi) për vendosjen e gypave të rinjë rrezikon gypat ekzistues, dhe po ashtu nuk na premtonte koha e shkurtër që kemi ne dispozicion për dorëzimin e njërive tek blerësit tanë dhe lidhjen e rrymës për te gjitha ato njësi. Kërkesa jonë e specifikuar si më lart ka të bëjë ekskluzivisht me kyçjen e përkohshme të tri trafove të reja në ato ekzistuese, për një afat të shkurtër kohor në maksimum prej një viti”*.

**Provë:** Shkresa e datës 22.11.2023 drejtuar KEDS-it

Me datë 10.01.2024 Departamenti i shërbimeve për konsumatori në KEDS, ka lëshuar përgjigjen në të cilën thuhet se: *“kërkesa juaj e datës 22.11.2023 nr.10425 për ndryshimin e zgjidhjes teknike (të dhënë*



paraprkisht me PEE nr. 7696 dt.28.07.2023) për kyçje të përkohshme në daljen 10/20 kV ekzistuese prej nga furnizohen në mënyrë të përkohshme dy transformatorët ekzistues me nr. 19000078223 dhe nr. 19000078224 është refuzuar dhe rrjedhimisht mbesin në fuqi kushtet teknike të dhëna përmes Pëlqimit Elektroenergjetik paraparak nr.7696 dt. 28.07.2023”.

**Provë:** Përgjigja e KEDS nr. 278 datë 10.01.2024

Me datë 04.01.2024 dhe 19.01.2024 i pakënaqur me përgjigjen e KEDS-it, aplikuesi brenda afatit ligjor paraqet ankesë pranë DMK-së në ZRRE, duke kontestuar refuzimin e kërkesës së tij nga ana e KEDS-it.

**Provë:** Ankesat e datës 04.01.2024 dhe 19.01.2024 ne DMK

Bordi i ZRRE, duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e aplikuesit për kyçje dhe KEDS-it, ka vërejtur se:

Aplikuesi B.P “TREGTIA”SHPK me datë 26.06.2023 ka aplikuar në KEDS për Pëlqim Elektroenergjetik për kyçjen e objekteve të reja R9 dhe R7.

**Provë:** Kërkesa për Pëlqim Elektroenergjetik nr.1116110 të datës 26.06.2023

Bazuar në kërkesën e aplikuesit, KEDS me datë 28.07.2023 ka lëshuar Pëlqimin Elektroenergjetik dhe Zgjidhjen Teknike nr.7696, ku në PEE është theksuar se: “Aplikuesi është pajisur fillimisht me PEE nr.3901 datë 18.06.2019 me furnizim nga TS ekzistues për energjizim të punishtes (Pmnj= 150 kW) për ndërtimin e kompleksit të ri afaristo banesor “Kodrina”. Pastaj aplikuesi është pajisur me PEE nr. 5082 datë 08.06.2021 përmes kësaj PEE i është lejuar kyçje e përkohshme si dhe ndërtimi i dy trafo stacioneve të reja me fuqi  $S_n=2 \times 1600 \text{ kVA}$ , dhe është cekur në PEE që në PEE-t e ardhshme aplikuesi duhet të implementoj linjën e re 10(20) kV nga NS i KOSTT-it deri në kompleksin “Kodrina” ku duhet të kyçen të gjitha objektet tjera duke përfshirë edhe blloqet R9 dhe R10. Investitorit i është përgatitur PEE nr. 6579 dt. 01.07.2022 për kyçjen e përkohshme të punishtes në trafo stacionin me kod: 19000078223 , të cilin PEE nuk e ka realizuar. Pastaj aplikuesi është pajisur me PEE nr. 12677 dt. 05.12.2022 për realizimin e linjës nga NS 110/10(20)kV Prishtina 7, të cilën PEE nuk e ka realizuar. Aplikuesi tani ka bërë kërkesë që lënda të procedohet përmes Metodologjisë së taksave për kyçje”. Në PEE janë dhënë edhe të dhënat të dhënat e përgjithshme rreth fuqisë së transformatorëve (TS3, TS4, dhe TS5) dhe njësisve banesore që do të kyçen në këto transformatorë. Po ashtu në PEE janë dhënë kushtet teknike të kyçjes, si nënstationin se nga do të furnizohen objektet, niveli i tensionit, dalja 10(20) kV, vendi i kyçjes, vendi i pikave matëse dh mënyra e kyçjes.

**Provë:** PEE dhe ZT nr. 7696 datë 28.07.2023

Bordi i ZRRE-së bazuar në shqyrtimin e te gjithë dokumentacionit, kërkesën e konsumatorit për kyçje si dhe PEE dhe ZT nr.7696 të datës 28.07.2023 konstaton se aplikuesi B.P “TREGTIA”SHPK me rastin e aplikimit për kyçje ka vepruar konform nenit 8 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji elektrike, si dhe nenin 9 të Metodologjisë së Taksave të kyçjes së OSSH e ku thuhet se: “Çdo person fizik apo juridik, gjenerator/prodhues apo Konsumator Prodhues mund të aplikojë për kyçje të re apo modifikim të kyçjes ekzistuese në Sistemin e Shpërndarjes, me qëllim të furnizimit me energji elektrike apo gjenerimit të energjisë elektrike”, kurse në paragrafin 3 nën-paragrafi 3.1 i këtij neni thekson: “Përdoruesit ekzistues ose të ardhshëm të sistemit të shpërndarjes duhet të marrin ofertën e kyçjes për kyçje në sistemin e shpërndarjes nga OSSH kur ndërtojnë objekte të reja që duhet të lidhen me sistemin e shpërndarjes”. Në nenin 10 të Metodologjisë së Taksave të kyçjes së OSSH po ashtu janë të përcaktuara edhe fazat e procesit të kërkesës për kyçje dhe shqyrtimi i kërkesës së aplikuesit për kyçje në sistemin e shpërndarjes, si dhe për modifikimin e kyçjes aktuale. Bordi i ZRRE në vijim të kësaj thekson se edhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka respektuar nenin 9 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji dhe nenin 10.2 duke përgatitur ofertën për kyçje, përkatësisht ka lëshuar PEE dhe ZT nr.4727 të datës 31.05.2023 me te cilat janë te përcaktuara të gjitha kushtet teknike të cilat duhet të plotësohen para kyçjes, përfshirë edhe vendin ku do të bëhet kyçja, gjithmonë



bazuar në kërkesën dhe projektin e dorëzuar nga aplikuesi për kyçjen e tre objekteve me 1,142 njësi banimi dhe me fuqi prej Pmnj=3997 kW. Ky pëlqim po ashtu ka përfshirë edhe kyçjen e dy TS të mëhershëm të cilëve u është dhënë kyçja e përkohshme.

Me datë 21.08.2023 aplikuesi bazuar në Pëlqimin Elektroenergjetik dhe Zgjidhjen Teknike nr. 7696 te datës 28.07.2023 ka aplikuar Departamentin e Investimeve në KEDS për aprovim projekti duke marrë për bazë kanal in ekzistues të KEDS-it. Në vijim të kësaj me datë 28.08.2023 Departamenti i Investimeve i OSSHi ka kthyer përgjigje aplikuesit me vërejtjet si: i) Linja e re nga NS Prishtina 7 deri te "Stabilimenti 1" duhet të shtrihet në kanal të ri me gypa dhe puseta. Kanali të hapet përgjatë vijës së njëjtë me kanal in ekzistues në anën tjetër të rrugës; ii) Në situacionin të specifikohet lloji i kanalit të ri që do të hapet brenda kampusit të objekteve. Kanali duhet të ketë gypa të mjaftueshëm në mënyrë që kabllot e Tensionit të Ulët (TU) të vendosen në gypa të veçantë; iii) Në skemën njëpolare të Tensionit të Mesëm (TM) të vendoset edhe kthina dalëse në NS Prishtina 7. Pas kësaj aplikuesi ka bërë kërkesë për takim me zyrtaret e KEDS-it me qëllim të rishqyrtimit të vërejtjeve të dhëna nga Departamenti i investimeve te datës 28.08.2023 dhe mbi mundësinë e përdorimit të kanalit ekzistues te KEDS-it, Departamenti i investimeve me date 06.11.2023 ka lëshuar/ka kthyer përgjigje kompanisë për projektin e dorëzuar me vërejtjet si: i) Linja e re nga NS Prishtina 7 deri te "Stabilimenti 1" duhet të shtrihet përgjatë trasesë së kanalit ekzistues ashtu që pas implementimit të linjës së re në kanal duhet të mbeten dy gypa lire; ii) Në situacionin me ortofoto të specifikohet lloji i kanalit të ri që do të hapet brenda kampusit të objekteve. Kanali duhet të ketë gypa të mjaftueshëm në mënyrë që kabllot e TU të vendosen në gypa të veçantë ose duhet të rritet seksioni i daljeve të TU; iii) dhe Dokumentacioni i nënshkruar dhe i vulosur në dy kopje mund të sillen në KEDS.

Pas kësaj aplikuesi me datë 22.11.2023 i është drejtuar përmes shkresë zyrtare KEDS-it ku ka theksuar se përmes kësaj shkresë kërkojmë mirëkuptimin tuaj për sa i përket kërkesës tonë për kyçje të përkohshme të tri trafove të reja nëpërmjet trafove aktuale ekzistuese në linjën 10 kV. Në kërkesë po ashtu është specifikuar se: *“Ne pa humbur kohë e kemi realizuar projektin sipas udhëzimeve të dhëna nga ana juaj dhe të njëjtin e kemi dorëzuar menjëherë tek ju për aprovim. Pas pak kohe na është thënë që të njëjtin projekt nuk e ka pranuar komisioni, ndërsa kanë kërkuar që të një trase e re prej 3.5 km, për të cilën realisht konsiderojmë se ka qenë një investim i paralizueshëm në praktikë. Pas kësaj me datë 05.10.2023 ne kemi bërë kërkesë për takim me drejtorin ekzekutiv Alpin Dogan në mënyrë që të kishim mundësinë të diskutonim dhe po ashtu të gjenim zgjidhje për problemet eventuale në lidhje me kushtet për te cilat kishim aplikuar. Pas takimit, menjëherë pas kësaj ne kemi bërë projektin por një ekzekutim te tillë, lidhur me këtë kemi vërtetuar gjendjen e pusetave (shaktave) dhe trasesë, dhe kemi parë se është vështirë e realizueshme ne terren, për arsye se rrëmihja (gërmimi) për vendosjen e gypave të rinjë rrezikon gypat ekzistues, dhe po ashtu nuk na premtom koha e shkurtër që kemi ne dispozicion për dorëzimin e njërive tek blerësit tanë dhe lidhjen e rrymës për te gjitha ato njësi. Kërkesa jonë e specifikuar si më lart ka të bëjë ekskluzivisht me kyçjen e përkohshme të tri trafove të reja në ato ekzistuese, për një afat të shkurtër kohor në maksimum prej një viti”* Po ashtu ne këtë shkresë i propozohet KEDS qe: *“Propozimi ynë ishte në të shkojmë bashkë me kompanitë tjera të cilat do t’i preferojë shërbimi juaj për investimin e linjës së re komplet me puseta (shakta) dhe me gypa. E vetmja kërkesë është që shërbimi juaj të marrë lejen e kësaj traseje të re nga Kuvendi Komunal i Komunës së Prishtinës si dhe t’i orientojë edhe investitorët tjerë që duhet ta shfrytëzojnë këtë trase”*.

Bordi i ZRrE ka shqyrtuar kërkesën e aplikuesit dhe informon se neni 10.3 paragrafi 1 dhe 4 i Metodologjisë së taksave të Kyçjeve të OSSH përcakton edhe detyrimet e palëve lidhur me Pranimin të ofertës për kyçje të OSSH, e ku thuhet se: *“1. Nëse Aplikuesi dëshiron të pranojë ofertën e OSSH-së për tu kyçur në Sistemin e Shpërndarjes, ai duhet ta pranojë atë ofertë në pajtim me të gjitha kushtet e saj, përfshirë: kushtet e zgjidhjes teknike, mundësinë që OSSH të bëjë implementimin e rrjetit të ri si edhe mundësinë e transferimit të aseteve të Aplikuesit të OSSH. Në rastet e refuzimit nga pala për transferin e aseteve tek OSSH, atëherë pika matëse do të vendoset në pikën e kyçjes së OSSH”, dhe “4. Në rast se*



Aplikuesi zgjedh që punimet do të ndërmerren nga një kontraktues i licencuar, atëherë Aplikuesi në bashkëpunim me kompaninë e licencuar është përgjegjës për furnizimin, ndërtimin dhe instalimin e aseteve të reja dhe aty ku është e nevojshme edhe të aseteve të përforcimit. OSSH mban të drejtën e mbikëqyrjes së punimeve ndërtimore dhe të instalimit të aseteve elektrike. Aplikuesi gjithashtu merr përgjegjësinë për sigurimin e të gjitha lejeve të nevojshme sipas ligjeve të Kosovës. Gjithashtu, Aplikuesi duhet t'ia siguroj OSSH emrin e kompanisë së licencuar dhe duhet të siguroj edhe emrat përgjegjës që do të punojnë për ndërtimin dhe instalimin e aseteve të reja, në mënyrë që OSSH t'ia siguroj leje hyrjet për të kryer punimet". Pra nga këto dispozita vërehet se kur aplikuesi ka filluar të paraqet kërkesa te OSSH lidhur me ofertën për kyçje, si ajo që OSSH të marr lejet nga Komuna, atëherë a qenë në kundërshtim me nenin 10.3 pika 4. Gjithashtu duhet theksuar se për rastet kur aplikuesi nuk është i kënaqur me kushtet e ofruara nga OSSH atëherë i njëjti bazuar ne paragrafin 6 të këtij neni ka te drejtë të kundërshton në OSSH. Në paragrafin 6 të nenit 10.3 të Metodologjisë së Taksave për Kyçje të OSSH theksohet se: "Nëse Aplikuesi nuk është i kënaqur me kushtet e ofruara nga OSSH ose me trajtimin e kërkesës për kyçje të OSSH-së, Aplikuesi mund të iniciojë një ankesë pranë OSSH sipas Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë. Nëse Aplikuesi ende nuk është i kënaqur me veprimet e OSSH-së ka të drejtë të iniciojë ankesë pranë Rregullatorit". Po ashtu ZRRE informon aplikuesin se kyçja e përkohshme në TS ekzistues edhe përkundër që të njëjtat nuk ngarkohen me kapacitet të plotë apo që sipas të njëjtit ngarkesa e këtyre trafove është TS1 - 27.32% dhe TS2 - 17.9%, nuk lejohet për shkak se ai kapacitet është i kontraktuar për konsumatorët e kyçur të objekteve për të cilat edhe është pranuar projekti elektrik me PEE nr. 5082 të datës 08.06.2021, dhe me këtë është pajtuar edhe aplikuesi kur ka marrë PEE nr. 5082 të datës 08.06.2021.

Ne kërkesën e aplikuesit me datë 10.01.2024 është përgjigjur Departamenti i shërbimeve për konsumatorë në KEDS, i cili ka lëshuar përgjigjen në të cilën thuhet se: "kërkesa juaj e datës 22.11.2023 nr. 10425 për ndryshimin e zgjidhjes teknike (të dhënë paraprakisht me PEE nr. 7696 dt. 28.07.2023) për kyçje të përkohshme në daljen 10/20 kV ekzistuese prej nga furnizohen në mënyrë ë përkohshme dy transformatorët ekzistues me nr.19000078223 dhe nr.19000078224 është refuzuar dhe rrjedhimisht mbesin në fuqi kushtet teknike të dhëna përmes Pëlqimit Elektroenergetik paraprak nr.7696 dt. 28.07.2023". ZRRE informon aplikuesin se kyçjet e përkohshme janë te përcaktuara me Metodologjinë e Taksave të Kyçjes së OSSH-së përkatësisht me nenin 13.1 paragrafin 1, 2 dhe 3 e ku thuhet se: **1. OSSH mund të sigurojë një lidhje të përkohshme për të furnizuar me energji elektrike kompanitë për ndërtim që po ndërtojnë një shtëpi të re, objekte kolektive banesore apo objekte të biznesit. Kërkesa për kyçje të përkohshme mund të bëhet nëpërmjet kompanisë për ndërtim. Një lidhje e përkohshme do të regjistrohet si konsumator komercial për një afat maksimal prej 180 ditësh, çfarëdo zgjatje do të rikonfirmohet përmes aplikimit dhe ndjekjes së procedurës për kyçje të përkohshme;** **2. Të gjitha instalimet e bëra nga ana e aplikuesit deri në pikën e kyçjes, janë përgjegjësi e kompanisë për ndërtim. Palët e treta nuk mund të përfitojnë nga lidhja e përkohshme. Nëse transformatori dhe linja e furnizimit nuk janë instaluar në mënyrë të përhershme, pasi të jetë përfunduar aktiviteti për kyçje të përkohshme, instalimi do të çmontohet nga kompania për ndërtim;** **3. Pas përfundimit të kyçjes së përkohshme, Aplikuesi rezident duhet të aplikoj për kyçje të përhershme në pajtim me dispozitat ligjore të kësaj Metodologjie".** Pra nga kjo shihet qartë se kyçje e përkohshme në rastin e kërkesës së aplikuesit për kyçjen e 1,142 njësive banimi dhe me fuqi prej Pm<sub>nj</sub>=3997 kW nuk lejohet, por ato lejohen vetëm pasi të plotësohen kushtet teknike të dhëna në PEE dhe ZT nr. 7696 datë 28.07.2023.

Bordi i ZRRE informon aplikuesin se sipas nenit 9 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ekzistojnë dy lloje të Kyçjes: Kyçje e cekët dhe kyçje e thellë. Për më tepër sipas nenit 8 të Metodologjisë së Taksave për Kyçje të OSSH, theksohet se:

**"1. Në varësi të kushteve teknike të kyçjes në sistemin e shpërndarjes, ekzistojnë dy lloje kryesore të kyçjeve, që përcaktohen në nenin 9 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimi me Energji**





**dhe përkufizohen në nenin 2 të Parimeve të Përcaktimit të Tarifave të Shfrytëzimit të Rrjetit të Shpërndarjes dhe Taksave për Kyçje:**

**1.1. Kyçje e Cekët - është një kyçje në rrjetin e shpërndarjes për të cilën nuk ka nevojë për zgjerim apo përforsim të rrjetit ekzistues:**

**1.1.1 Kyçje e Cekët” nënkupton se Aplikuesi do të mbuloj vetëm ato kosto që shkaktohen nga krijimi i një kyçjeje të re në pikën më të afërt të përshtatshme të rrjetit ekzistues të shpërndarjes të përcaktuar nga OSSH.**

**1.2. Kyçja e thellë – është një kyçje në rrjetin e shpërndarjes, për të cilën ka nevojë për zgjerim, dhe apo përforsim të rrjetit ekzistues, për të përmbushur kërkesën e aplikuesit.**

**1.2.1 Kyçja e thellë nënkupton se, aplikuesi do të mbuloj kostot e asetëve të nevojshme për kyçje, në pikën më të afërt të përshtatshme të kyçjes në sistemin ekzistues të shpërndarjes, plus çfarëdo kostosh indirekte që shkaktohen nga punë të ndërlidhura me përforsimin, zgjerimin apo rikonfigurimin e rrjetit ekzistues, e të cilat shkaktohen si pasojë direkte e operimit të pikës së kyçjes”.**

Kësisoj Bordi i ZRRE thekson se kyçja për të cilën ka aplikuar Ankuesi, është kyçje e thellë, për të cilën nevojitet zgjerim, dhe për të cilën, Aplikuesi/Ankuesi do t'i mbuloj kostot e nevojshme për ta realizuar këtë kyçje.

Bordi i ZRRE-së, ka analizuar me kujdes pretendimet e ngritura nga përfaqësuesi i autorizuar i Ankuesit Pallaska & Associates, e dt. 19 janar 2024, dhe sqaron, si në vijim:

- Ankuesi pretendon që, ndërtimi i linjës së veçantë nga NS KOSTT deri në kompleksin Kodrina nuk ka bazë faktike dhe juridike, për faktin se, nuk janë ndërtuar të gjitha objektet ashtu siç është planifikuar, e që mund të zgjas 7 deri në 8 vite, ose potencialisht, finalizimi i tyre është rrethanë e ardhshme e pasigurt.

Bordi thekson se, duke qenë se Kompleksi Urban “Kodrina” duke iu referuar Planit Rregullues të Komunës së Prishtinës të dt. 17.05.2017, planifikohet të përfundohet për një periudhë kohore dhjetë (10) vjeçare dhe rrjedhimisht, kjo nënkupton që ky projekt investiv – ndërtimor është një projekt i madh, në të cilin do të ndërtohen disa objekte, për çka, edhe KEDS-i me datë 23.04.2019, i ka lëshuar Ankuesit PEE-në me nr. 2625, në të cilën i është sqaruar se “Linjat distributive 10(20) kV, që shtrihen në afërsi të objektit tuaj, janë të mbingarkuara dhe nuk kanë kapacitet të mjaftueshëm për të përballuar edhe kyçjen e trafostacionit tuaj të ri privat në këto linja, trafostacion ky të cilin ju do ta konstruktioni për furnizim me energji elektrik të punishtes për ndërtimin e Lagjes Kodrina, me kushtet teknike si në shkresat e lëndës”. Fillimisht, ky PEE i është lëshuar Ankuesit, për ndërtimin e trafostacionit, për energjizimin e punishtes, me qëllim që të ndërtohet Lagja Kodrina. Duhet theksuar se, qysh në këtë PEE, Ankuesit i është kërkuar që të ndërtoj linjën 10(20) Kv, me gypa dhe puseta, me kablllo nëntokësore, si vijon: “Nga kthina kyçëse, e deri në kthinën hyrëse, të TS të ri, do të realizohet linja 10(20) kV, me gypa dhe puseta, me kablllo nëntokësore ... “ dhe se furnizimi i objektit duhet te bëhet nga NS 110/10(20) kV “Prishtina 7” (PEE me nr. 2625, i dt. 23.04.2019). E duke qenë se, Ankuesi, në pamundësi të realizimit të kushteve të dhëna sipas PEE paraprake (nr.2625), KEDS, i ka lëshuar një PEE të ri, me nr. 3901, të dt. 18.06.2019, në të cilin është specifikuar si vijon: “Kjo zgjidhje është e përkohshme, vetëm për punishte të Lagjes Kodrina, deri sa lagja të përfundohet, pasi që investitori ka kërkuar revidimin e PEE, konkretisht, kushte të reja teknike për kyçjen e punishtes ... “. Pra, ky PEE është lëshuar si zgjidhje e përkohshme, për përfundimin e punimeve për ndërtimin e projektit.

Përsëri, edhe në PEE nr. 5082 të dt. 08.06.2021, KEDS, i kishte bërë të ditur Ankuesit faktin se: “Me PEE të ardhshëm (të ri) për kyçjen e objekteve tjera, investitori duhet të implementoj linjën e re 10(20) kV, nga NS i KOSTT-it, deri në kompleksin “Kodrina” ku duhet të kyçen të gjitha objektet, duke



**përfshirë edhe Blloqet R9 dhe R10. ...**". Pra, ky Pëlqim, ka qenë i përkohshëm, me kushtin që, të ndërtohet Linja e Re.

Me datë 01.07.2022, Ankuesit i është lëshuar PEE me nr. 6579 – i reviduar, në të cilin është theksuar si në vijim: *"Tani investitori, për shkak që në atë zonë është duke ndërtuar objekte të tjera, ka kërkuar që njehsori ekzistues, të bartet nga trafostacioni, ku është aktualisht i kyçur, në një trafostacion tjetër, afër punishtes, i cili është pronë e investitorit ..."* dhe rrjedhimisht, sipas kërkesës së investitorit, KEDS i ka lëshuar një PEE të ri, me kushte teknike si në shkresat e lëndës.

Po ashtu, edhe me datë 05.12.2022, Ankuesit i është lëshuar PEE me nr. 12677 – i reviduar, në të cilin është sqaruar se, PEE i dt. 01.07.2022, Ankuesi nuk e ka realizuar, dhe i është drejtuar KEDS me kërkesë të re, për kyçje të objekteve R7 dhe R9, me specifikat për objekte dhe kapacitet si në shkresat e lëndës.

Pra duhet theksuar se aplikuesi që nga viti 2019 ka qenë i njoftuar se duhet të ndërtohet linja nga aplikuesi dhe i është dhënë disa herë PEE dhe ZT, megjithatë edhe tani aplikuesi kërkon që të ketë kyçje të përkoheshme.

- Ankuesi, më tej pretendon që, Pëlqimi Elektroenergjetik, nr. 7696 i dt. 28.07.2023, si edhe Zgjidhja Teknike, **nuk e përmbajnë kërkesën** që, Tregtia të vendos linjën e vet në një kanal të ri me gypa dhe puseta në anën tjetër të rrugës.

Bordi thekson se, ky pretendim si i tillë nuk qëndron, sepse, në PEE nr. 7696 të dt. 28.07.2023, si edhe në Zgjidhjen Teknike nr.7696, ndër të tjera, theksohet si vijon: " ... i është cekur në PEE, që në PEE-të e ardhshme, **aplikuesi duhet të implementoj Linjën e Re 10(20) kV, nga NS i KOSTT-it, deri në kompleksin Kodrina**, ku duhet të kyçen të gjitha objektet e tjera, duke përfshirë edhe blloqet R9 dhe R10. Po ashtu, edhe në Zgjidhje Teknike, theksohet si vijon: "Nga kthina e re dalëse, 10(20) kV, e cila do të vendoset në NS 110/10(20) kV, Prishtina 7, e deri te kthina hyrëse e stabilimentit të ri "Stabilimenti 1", **duhet të realizohet linja e re nëntokësore 10(20) kV, me kablo të tipit XHE 3x1x240 mm<sup>2</sup>, sipas projektit elektrik me gypa dhe puseta, i cili paraprakisht duhet të aprovohet nga departamenti i investimeve**". Pra, si PEE edhe Zgjidhja Teknike me nr.7696, e përmbajnë Kërkesën që Ankuesi duhet të ndërtojë linjën e re, gypa dhe puseta, si në shkresat e sipërmendura.

- Ankuesi, më tej pretendon që, KEDS me datë 28.08.2023, përmes email, i ka komunikuar Ankuesit se, linja e re, për bllokun R7, R8 dhe R9 – Faza e dytë, dhe dy hyrje të bllokut R4, duhet të vendoset në Kanalin e Ri – PEE nr. 7696, apo ndryshe i referohen edhe si "Ndryshim i Kundërligjshëm i Zgjidhjes Teknike".

Nga analizimi i shkresave të lëndës Bordi ka gjetur se, nuk kemi të bëjmë me ndryshim të kundërligjshëm të Zgjidhjes Teknike, por që, proceduralisht, pasi që Ankuesit i është ofruar PEE dhe Zgjidhja Teknike me nr. 7696, Ankuesi e ka dorëzuar projektin për aprovim, në Departamentin e Investimeve në KEDS, pasi që ishte verifikuar gjendja në terren. Më tej, pasi që është shqyrtuar projekti, Ankuesi ishte njoftuar nga KEDS se: *"Linja e Re nga NS Prishtina 7 e deri te Stabilimenti 1 duhet të shtrihet në kanal të ri me gypa dhe puseta në anën tjetër të kanalit. Kanali të hapet përgjatë vijës së njëjtë, me kanalin ekzistues, në anën tjetër të rrugës."* Pra, ky email, përmban vërejtjet që Departamenti i Investimeve i ka identifikuar në projektin e paraqitur nga Ankuesi, dhe kësaj, nuk kemi të bëjmë me Ndryshim të Kundërligjshëm të Zgjidhjes Teknike, pasi që, Ankuesit, që nga viti 2019, i është bërë e ditur, që duhet të ndërtohet Kanali i Ri, dhe se, kyçjet e përkohshme, janë vetëm zgjidhje e përkohshme, deri në finalizimin e projektit. Për më tepër, zgjidhjet që Ankuesit i janë ofruar, kanë pasur për qëllim lehtësimin e realizimit të projektit, dhe si të tilla, kanë derivuar nga takimet e tyre të përbashkëta. Për më shumë, palët edhe me datë 05.10.2023, kanë mbajtur një takim pune, dhe nga ky takim, u është ofruar një mundësi e re, që të përdorin pusetat e njëjta, por që të vihen gypa të rinj.



Përsëri, siç sqarohet në ankesën e Ankuesit të dt. 03.01.2024, ekipi profesional, pasi që ka bërë të gjitha analizat e nevojshme për zhvillimin e punëve, ka vërtetuar se, është e pamundur të rrëmihet (gërmohet) mbi ata gypa, për arsye se do të ishte i pa evitueshëm dëmtimi i gypave ekzistues. Të njëjtit, as këtë zgjidhje teknike (që ka derivuar nga takimi) nuk e kanë pranuar, dhe përsëri kishin kërkuar një takim tjetër, i cili nuk u ishte mundësuar nga kompania KEDS. Pra, ZRrE ky pretendim si i tillë nuk qëndron, sepse këtu kemi të bëjmë me ofrimin e zgjidhjeve praktike nga KEDS-i për Ankuesin, edhe nga takimet e përbashkëta që palët i kanë mbajtur mes tyre.

- Me datë 22.11.2023, Ankuesi ka parashtruar Kërkesë për Kyçje të Përkohshme, për blloqet R7 dhe R9. Ankuesi, më tej ka theksuar gatishmërinë e vet, që në të ardhmen, do të marr pjesë në ndërtimin e kanalit të ri, së bashku me të gjitha palët e interesuara në baza proporcionale.

Lidhur me këtë pretendim, Bordi ju njofton që ndërtimi i këtij objekti është në përgjegjësi të Ankuesit Tregtia, dhe i njëjti duhet të kujdeset që të kryer edhe punët tjera të nevojshme që kanë të bëjnë me furnizimin e rregullt me energji elektrike të banorëve. Për më tepër, duke qenë se kërkesa e Ankuesit ka të bëjë me Kyçje të Thellë, barra financiare bie mbi Ankuesin, si për kostot e nevojshme të asetëve për kyçje, po ashtu edhe për kostot indirekte që shkaktohen nga punë të ndërlidhura me përforcimin, zgjerimin ose rikonfigurimin e rrjetit ekzistues.

- Me datë 10.01.2024, KEDS-i i përgjigjen Ankuesit, përmes Përgjigjes nr. 278 ose Akti i Apeluar, duke e refuzuar kërkesën për Kyçje të Përkohshme, për shkak të nevojës për ndërtimin e Kanalit të Ri. Sipas Ankuesit, KEDS nuk ka ofruar bazë ligjore ose rregullative, për refuzimin e kësaj kërkesë, sepse, një bazë e tillë ligjore apo rregullative nuk ekziston.

Bordi ka analizuar me kujdes Aktin e Apeluar, ose Përgjigjen me nr. 278, dhe thekson, e njëjta përmban sqarimet e nevojshme rreth refuzimit të kërkesës së Ankuesit, si dhe kronologjinë e kërkesave dhe PEE e Zgjidhjeve Teknike që i ishin ofruar Ankuesit, duke e sqaruar përfundimisht faktin se, për shkak se ky është një projekt shumë i madh, është dashur që nga viti 2021, të fillohet me implementimin e linjës së veçantë, nga NS KOSTT-i, si dhe, e njëjta kërkesë është ripërsëritur edhe në vitin 2022 dhe në vitin 2023. Duhet theksuar se, PEE dhe Zgjidhja Teknike, janë dokumente praktike – teknike, të cilat përmbajnë të dhëna teknike, të tilla si materialet, pajisjet dhe punët e përfshira se si do të realizohet një projekt i caktuar për të cilin edhe palët aplikojnë në KEDS, dhe jo domosdoshmërisht duhet të përmbajë elementet e një vendimi sipas nenit 47 të LPPA.

- Metodologjia e Taksave të Kyçjes për OSSh-në, neni 9.3. 1.1. – “ .. kur ndërtojnë objekte të reja që duhet të lidhen me sistemin e shpërndarjes” . Sipas Ankuesit, PEE-të, janë në kundërshtim me këtë bazë ligjore, sepse, vendosin mbi Ankuesin një barrë të papërbalueshme financiare, në formë të kushtëzimit të kundërligjshëm, për të ndërtuar infrastrukturë të shpërndarjes së energjisë për ndërtesa që nuk janë ndërtuar.

Bordi sqaron se, me të aplikuar në KEDS për PEE, Ankuesi e ka njoftuar KEDS për projektin dhe për kapacitetin i cili do të nevojitet në të ardhmen për të mbuluar kërkesën për energji elektrike për banorët e kësaj lagje. Duke pasur se aplikuesi ka vepruar konform nenit 9 të metodologjisë së Kyçjes s, KEDS ka respektuar nenin 10 të kësaj metodologjie duke përgatitur ofertën e kyçjes sipas kërkesës së aplikuesit.

- Ankuesi më tej pretendon që, Akti i Apeluar e hesht në tërësi nenin 13 të Metodologjisë për Kyçjet e Përkohshme, përkundër që kërkesa e ankuesit ishte paraqitur mbi këtë bazë rregullatore.

Duke iu referuar nenit 13.1 të Metodologjisë së Taksave për Kyçje, sqarohet si vijon:“ 1.OSSH mund të sigurojë një lidhje të përkohshme për të furnizuar me energji elektrike kompanitë për ndërtim që po ndërtojnë një shtëpi të re, objekte kolektive banesore apo objekte të biznesit. Kërkesa për kyçje të





përkohshme mund të bëhet nëpërmjet kompanisë për ndërtim. Një lidhje e përkohshme do të regjistrohet si konsumator komercial për një afat maksimal prej 180 ditësh, çfarëdo zgjatje do të rikonfirmohet përmes aplikimit dhe ndjekjes së procedurës për kyçje të përkohshme. 2 Të gjitha instalimet e bëra nga ana e aplikuesit deri në pikën e kyçjes, janë përgjegjësi e kompanisë për ndërtim. Palët e treta nuk mund të përfitojnë nga lidhja e përkohshme. Nëse transformatori dhe linja e furnizimit nuk janë instaluar në mënyrë të përhershme, pasi të jetë përfunduar aktiviteti për kyçje të përkohshme, instalimi do të çmontohet nga kompania për ndërtim. 3 Pas përfundimit të kyçjes së përkohshme, Aplikuesi rezident duhet të aplikoj për kyçje të përhershme në pajtim me dispozitat ligjore të kësaj Metodologjie. 4 Organizimet apo ngjarjet publike njëditore (apo maksimumi 1 muaj) nuk do të trajtohen nga OSSH-ja, si një lidhje e përkohshme në rrjet; ato mund të jenë të lidhura në njëhësorë që i përkasin komunës në vende të caktuara (sheshe, zonë për këmbësorë). Për këto kërkesa për kyçje, Komuna mund t'iu lejojë që ata të lidhen në rrjetin e ndriçimit publik kudo, bazuar në fuqinë e tyre të kontraktuar". Pra, nga sa mund të shihet nga kjo dispozitë ligjore, Kyçjet e Përkohshme lejohen vetëm në raste të veçanta, dhe pas përfundimit të ndërtimit të projektit, Aplikuesi duhet të aplikoj për kyçje të përhershme.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka analizuar të gjitha Pëlqimet Elektroenergjetike, si dhe Zgjidhjet teknike të lëshuar nga KEDS për aplikuesin "TREGTIA", sa i përket ndërtimit në lagjen KODRINA, PEE nr.2625 datë 23.04.2019, PEE nr.3901 datë 18.06.2019, PEE nr. 5082 datë 08.06.2021, PEE nr. 6579 dt. 01.07.2022, PEE nr. 12677 dt. 05.12.2022 si dhe PEE dhe ZT nr. 7696 datë 28.07.2023 dhe konstaton se në të gjitha PEE, përveç PEE nr. 3901 datë 18.06.2019 e cila ka pasur të bëjë me kyçjen e përkohshme të punishtes, si dhe PEE nr.5082 datë 08.06.2021 i cili ka pasur të bëjë me Kyçjen e përkohshme të dy objekteve por në të cilin po ashtu është përcaktuar se: KEDS lëshon këtë PEE për kyçjen e përkohshme të dy Blloqeve R9 dhe R10 nga linjat ekzistuese të KEDS, mirëpo me Pëlqimin Elektroenergjetik të ardhshëm (të ri) për kyçjen e objekteve tjera, investitori duhet të implementoj linjën e re 10(20) kV nga NS i KOSTT-it deri në kompleksin "Kodrina" ku duhet të kyçen të gjitha objektet duke përfshirë edhe Blloqet R9 dhe R10, KEDS ka kërkuar nga Aplikuesi që për furnizimin e objekteve të ndërtuara në kompleksin Kodrina duhet të bëjë ndërtimin/realizimin e linjës nga NS 110/10(20)kV Prishtina 7.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët, e në veçanti kërkesën e konsumatorit për Pëlqimi Elektroenergjetik, përgjigja e KEDS nr. 278 datë 10.01.2024, PEE nr.2625 datë 23.04.2019, PEE nr.3901 datë 18.06.2019, PEE nr. 5082 datë 08.06.2021, PEE nr. 6579 dt. 01.07.2022, PEE nr. 12677 dt. 05.12.2022 si dhe PEE dhe ZT nr. 7696 datë 28.07.2023 Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Metodologjisë së taksave për kyçje të rrjetit të Shpërndarjes dhe Ligjin për Energji Elektrike LIGJI Nr. 05/L - 085, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

\_\_\_\_\_  
Lutfije Dervishi, Anëtare

\_\_\_\_\_  
Gani Buçaj, Anëtar

\_\_\_\_\_  
Arta Isufi, Anëtare

\_\_\_\_\_  
Adnan Preniqi, Anëtar

**Vendimi u dërgohet:**

- KEDS,
- Aplikuesit: **B.P, "TREGTIA" SHPK** dhe
- Arkivit të ZRRE-së.